




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel.0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e pestë (V) të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, më datë 29.6.2015 me këtë:

REND PUNE

- 1 Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2.1 Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Gjilanit 2016-2018
 - 2.2 Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kompetencat, përgjegjësit dhe punën e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit
 - 2.3 Propozim vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër (15 vite) personave fizik dhe juridik, ng.kadastrale P-70403013-01345-0
 - 2.4 Propozim vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim për ndërtimin e trafostacioneve 10(20)0.4 KV
 - 2.5 Propozim vendimi për themelimin e panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor
 - 2.6 Rekomandim i Komitetit për Arsim për ndarjen e bursave për nxënës të klasave të X-ta në SHML të Agrobiznesit "Arbëria" në Gjilan
 - 2.7 Informatë rreth vërshimeve në Komunën e Gjilanit

3 Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 10.15 min

Në punimet e Seancës së katërt (IV) morën pjesë:

Anëtarët e Kuvendit

Zëvendëskryetari i Komunës, z. Rexhep Kadriu

Drejtorët e drejtorive
Përfaqësuesi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Fazli Abdullahu
Përfaqësuesi i Shoqërisë Civile, z. Shaban Terziu
Përfaqësuesi i OJQ "Anamorava", z. Isa Shefkiu
Mediet

Seancën e pestë e hapi dhe udhëhoqi kryesuesja e Kuvendit e cila fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, zv/kryetarin e Komunës, z. Rexhep Kadriu, mediet dhe të gjithë të pranishmit në sallë dhe kërkoi që të verifikohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në seancën e pestë të KK-së.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar

Nga ana e sekretarisë u konstatua se në seancën e Kuvendit ishin të pranishëm 33 anëtarë, kurse munguan dy: Bajram Hasani dhe Arben Mehmeti.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- para se të hapim debatin për rendin e ditës fillimisht kërkoi që të inkorporohen edhe dy çështje të rëndësishme për rendin e punës: Ndarja e subvencioneve për teatrin, të cilën çështje e kemi debatuar në seancën e kaluar, prandaj kryetari i Komunës ka marrë vendim për subvencionim të aktiviteteve në mënyrë që t' i mundësohet funksionimi normal këtij institucioni kulturor.

Pasi që kryesuesja e lexoi vendimin e kryetarit për subvencionim të Teatrit, kërkoi nga anëtarët që ta votojnë edhe këtë propozim dhe të hyjë si pikë e veçantë e rendit të punës?

Aprovohet vendimi për subvencionim të Teatrit me 32 vota të anëtarëve të Kuvendit, nuk kishte kundër as abstenime.

Pikë tjetër e rendit të punës është edhe: Ndalimi i mjeteve motorike prej orës 19-23 e 30 min, rruga prej teatrit të Qyteti, në drejtim të Prishtinës dhe në anën tjetër deri në përfundim të Parkut të qytetit. Kjo ndalim bëhet me qëllim që t' i krijohen kushte më të mira qytetarëve e sidomos atyre që vijnë në pushime nga bota e jashtme e cila ndalesë do të vlejë prej datës 1.7.2015 deri më 31.8.2015.

Aprovohet edhe propozimi për qarkullim të automjeteve në rrugët dhe në kohën të cilat u lexuan nga vendimi i hartuar për këtë qëllim me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

Ju lus nëse ka dikush ndonjë diskutim për rendin e punës?

Fehmi Sylejmani- unë fillimisht të gjithë agjëruesve të Ramazanit i uroj agjërim të lehtë, duke dëshiruar që t' i u pranohet edhe para perëndisë kjo sakrificë njerëzore. Unë për rendin e ditës propozoj që sot të futet një pikë e rendit të punës: informatë për përfundim të vitit shkollor.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- pikat e rendit të punës duhet të propozohen me kohë dhe të përgatiten, por për shkak të transparencës ju lus të deklaroheni se kush është për këtë propozim të z. Sylejmani?

Nuk aprovohet propozimi i z. Sylejmani, sepse 5 ishin për, kurse të tjerët kundër.

Sahit Abazi-së pari shprehim kënaqësinë që e kemi reagimin e parë të Qeverisë për përmirësim të gjendjes në Teatër, por as kjo nuk është zgjidhje e dëshiruar, sepse ne po pretendojmë për ta bërë një Teatër adekuat për një qytet siç është Gjilani. Mirëpo ne në emër të grupit kërkujmë sqarim për cilësinë e harrimit të rrugëve që po ndodh në Gjilan, sepse nuk duhet pasur shumë eksperiencë dhe profesionalizëm për të parë se ky harrim është i cilësisë shumë të dobët. Mirëpo edhe në anën tjetër kemi asfaltime të rrugëve me një dinamik shumë të ngadalshme, kurse ndërkohë ka filluar ardhja e mërgimtarëve në Gjilan dhe menjëherë kanë filluar shenjat e para të bllokimit të qytetit. Duhet të jep dikush përgjegjësi pse është kjo cilësi kaq e dobët e asfaltimit të rrugëve? Gjithashtu nuk po e vërejmë ndonjë mirëmbajtje të drunjve dekorativ e të cilët janë rritur dhe po japin bukuri

Gjilanit, por mirëmbajta adekuate mungon dhe ata drunj mund të rrezikohen nga sëmurjet e ndryshme. Kërkojmë me ngulm që këta drunj të mirëmbahen, sepse gradualisht po bëhen letërnjoftimi i Gjilanit.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- sa i përket marketingut politik për Teatrin që po e bën opozita nuk qëndrojnë, sepse grupi më madh që e ka përkrah Teatrin është partia në pushtet në bashkëpunim me koalicionin dhe propozimi i opozitës pa vullnetin tonë nuk do të aprovohet. Ju lus të mos bëjmë politikë, por t' i ndihmojmë atyre njerëzve, sepse është një performancë e mirë për qytetin tonë. Sa i përket pikave të tjera drejtori i Shërbimeve Publike është këtu dhe dot ë jap informatë.

Bujar Nevzadi- së pari e shpreh shqetësimin tim, sepse nuk po na epet fjala sipas radhës pasi që ne jemi grupi i dytë më i madh në Kuvend.

Unë po i ngrit disa shqetësime të mia e të cilat i kam ngrit që disa muaj me radhë e të cilat janë:

1. Kam kërkuar që në rend pune të jetë pikë e rendit të punës: Ndërtimet pa leje, sepse është degraduar qyteti i Gjilanit, sidomos me anulimin e Drejtorisë së Inspeksionit.
2. Kemi kërkuar informatë Për pendën e Përlepnicës, sepse iu është bërë një dëm i madh nga vërshimet dhe ekziston rreziku që ajo pendë të shkatërrohet edhe më shumë e cila mund të jetë fatale për fshatin dhe më gjerë.
3. Nën të ndryshme më intereson për ta ditur se çka po ndodh me rrugën “Vali Ranxh” për të cilën është shpall tenderi, kurse asfaltimi nuk po fillon?
4. U.d i Shëndetësisë të na jap informatë për punëtorët e pranuar në ambulancë, sepse me këtë rast ka pasur shumë parregullsi !
5. Çka po ndodh me Shtëpinë e Kulturës në Përlepnicë pse nuk po vazhdojnë punimet?
6. Pse nuk po kompletohet Qeveria Komunale edhe pas dy vite qeverisje, por funksion me u.d ?
7. Çfarë dobie ka pasur Komuna nga vizitat turistike që po i bën kryetari i Komunës jashtë vendit?

Unë që nga fillimi kam thënë se ky kryetar Komune nuk ka punuar kurrë dhe nuk i ka sjell asnjë të mirë Gjilanit dhe po vazhdon degradimin dhe shkatërrimin e kësaj Komune, prandaj në emër të grupit të PDK-së kërkojmë që ky kryetar të jep dorëheqje dhe ta çlirojë Komunën e Gjilanit.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- në KPF është debatuar për kërkesat e juaja si : Shtëpia e Kulturës, Penda e Përlepnicës dhe dëmet nga vërshimet. Sot njëra prej tri propozimeve të z. Nevzadi sot është për diskutim (vërshimet), kurse të tjerat do të debatohen në seancën e radhës.

Arijetë Rexhepi – disa herë i kam bërë pyetje disa drejtorëve, por nuk kam marrë përgjigje, prandaj po i përsëris disa prej tyre. I drejtohem drejtorit i Kadstrit, Pronës dhe Gjeodezisë, sepse e kam kërkuar regjistrin e uzurpatorëve të pronës komunale të cilën përgjigje nuk e kam marrë, prandaj këtë pyetje e përsëris edhe sot.

Gjithashtu të na njoftoj se cilat prona komunale janë liruar nga uzurpatorët?

Pyetje të shpeshta i kemi bërë drejtorit të urbanizmit për ndërtimet pa leje për objektet të cilat janë ndërtuar në objektin e Sillosit, ati afër Gjumnazit, objektit afër Tregut të Gjelbër, Shkollës “Thimi Mitko” etj.

Një pyetje tjetër është për drejtorin e Urbanizmit përkritazi me ridizajnimin e planeve urbanistike në disa pjesë të qyteti të cilat lidhen me interesa individuale?

Valentinë Bunjaku Rexhepi- informata për ndërtimet pa leje do të debatohet në seancën e radhës, sepse kështu është vendos në KPF.

Mevlude Zejnullahu- unë e kam një kërkesë nga disa qytetarë në rrugën qarkore afër fushës së futbollit “Geti” e cila rrugë është e paasfaltuar(rruga “Rukie Haliti”. Në këtë rrugë shkaktohen vështirësi në qarkullim nga të reshurat atmosferike, prandaj kërkoj që të asfaltohet kjo rrugë, sepse është kërkesë e qytetarëve.

Po ashtu mirëmbajtja e rrugës qarkore fare nuk është në nivel, sepse aty janë krijuar barnishta të larta, janë mbyllur kanalet dhe gypat, prandaj uji hyn nëpër oborre të shtëpive.

Nevzad Isufi- unë po shfaq një shqetësim të qytetarëve përkritazi me rregullimin e shtratit të Lumit “Banja”, sepse qytetarët kanë ankesa se nuk po punohet sipas planit të paraparë , sepse ka devijime nga plani, varësisht se kush se reziston. Edhe pse disa qytetarë vullnetarisht i kanë liruar pronat, ka qytetarë të tjerë të cilët pretendojnë për t' i uzurpuar pronat. Kërkojmë sqarime se a janë këto informacione të sakta dhe pse veprohet kështu ? Gjithashtu ka

ankesa edhe nga fshati Kmetoc, sepse edhe pse është rregulluar infrastruktura në këtë fshat banorët nuk kanë ujë!
Kërkohet përgjigje pse ndodh kjo ?

Riad Rashiti- un kërkoi që pika 2.7 Informatë për vërshimet të hiqet nga rendi i punës, sepse nuk na është sjell asnjë material dhe nuk e kemi asnjë informacion edhe pse ne si grup i PDK-së me muaj të tërë kemi kërkuar raport. Mirëpo ju edhe në këtë informatë nuk e keni sjell asnjë detal se sa ka pasur dëme nga vërshimet, kujt iu kanë bërë dhe cilëve pronarë? Është joserioze që sot në këtë Kuvend ta diskutojmë këtë çështje të papërgatitur, sepse vlera këtij dëmi është 1.6 milion €. Mua më duket se është jo serioze të debatohet sot për këtë çështje.

Shqetësim tjetër është se kaluan plotë 18 muaj dhe dërgojmë pyetje, kërkojmë informacione nga Zyra e kryetarit të Komunës dhe drejtorive të ndryshme, por prej disa drejtorive marrim përgjigje, kurse nga disa nuk marrim, por me vonesë, kurse kryetari i Komunës në asnjë kërkesë nuk është përgjigjur. Unë po i drejtohem kryesueses dhe këtij Kuvendi se kryetari i Komunës po e injoron një kohë të gjatë Kuvendin dhe është duke bërë shkelje të KK-së, Statutit të Komunës, LVL-së dhe Ligjit për dokumente zyrtare.

Në seancën e fundit kam kërkuar Raportin e auditimit, prandaj duam për ta ditur për të cilin raport nuk kemi marrë përgjigje. Kryetari vazhdon të mos jetë prezent në seanca, ne i bëjmë pyetje me rëndësi, ai iu shmanget pyetjeve dhe nuk jep përgjigje. Mirëpo sot qenka zv/kryetari në seancë dhe mund të na jep informatë e cila ka të bëjë me ndërtimet pa leje.

Një deklaratë e ka dhënë kryetari i Komunës përkitazi me ndërtimet pa leje dhe e ka thënë se në këtë çështje janë përzier politika dhe biznesi. Është mirë të na epet sqarime se cila është pjesa politike dhe cili është ai biznes i cili është bashkë dyzuar dhe bëjnë krim të ndërtimit në Gjilan? Në këtë deklaratë të fundit kryetari na ka befasuar për të mirë, sepse ka deklaruar sikurse të ishte zëdhënës i PDK-së, sepse e ka deklaruar atë që ne e kemi ngrit një kohë të gjatë.

Drejtorit të Zhvillimit Ekonomik po i bëj një pyetje për Lumin Mirusha. Pse janë ndal punimet në këtë projekt, por as nuk është paraparë asnjë euro në listën e projekteve. Gjithashtu drejtori të na ep përgjigje përkitazi me shpenzimet që janë bërë në panairin e Cyrihut dhe cilat projekte janë prezantuar atje?

Valentinë Bunjaku Rexhepi- informata për vërshimet është dërguar në selitë e partive të juaja dhe është dorëzuar më 24.6.2015. Për pyetjet tjera janë drejtorët këtu dhe nën të ndryshme ata do të përgjigjen.

Jakup Bajrami- unë kam një vërejtje, sepse fillimi i punimeve të seancës po zgjatet shumë, sepse po bëhen shumë pyetje dhe kjo metodë po na humbë shumë kohë. Për këtë arsyeje unë sugjeroj që shefat e grupeve të partive të vijnë në seancë të përgatitur dhe ta marrin fjalën sa për dhënë vërejtje dhe sugjerime për të mos e marrë fjalën secili. Për seancat e tjera propozoj që shefat e grupeve ta marrin fjalën përkitazi me rendin e punës dhe jo ta marrin fjalën të tjerët, sepse ajo është humbje e kohës.

Bujar Nevzadi- kështu është si po thotë Jakupi, por problemi është që kryetari nuk prezanton në seancë qe plotë 18 muaj. Ne bëjmë pyetje vazhdimisht, por propozimet tona nuk futen në rend të punës. Të vijë kryetari në seancë të përgjigjet dhe seanca nuk do të zgjat. Në këtë mandat nuk vjen as kryetari as drejtorët në seancë dhe për këtë arsyeje ne duhet t' i debatojmë në çdo seancë.

Leonorë Bunjaku- tema për të cilën do të diskutoj nën të ndryshme ka të bëjë me arsimin për të cilën temë e sidomos për zbatueshmërinë e Korrikulës bërthamë në shkollat pilot-projekt. Të keni konsideratë për këtë çështje në pikën nën të ndryshme.

Valentinë Bunjaku Rexhepi- të gjitha pyetjet të cilat u adresuan sot nuk mund të përgjigjemi nën të ndryshme, sepse janë shumë, por drejtorët do të vlerësojnë se në cilat pyetje të përgjigjen, kurse ato që mbesin përgjigjen në seancën e radhës.

Me dy pikët të cilat i propozuam si shtesë, ajo për Teatrin dhe ndalimin e qarkullimit të mjeteve motorike në dy rrugë të qytetit prej orës 19-23.30, kush është për aprovim të rendit të punës?

Aprovohet rendi i punës me këtë plotësim me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 11 ishin kundër

Aprovimi i procesverbalit nga seanca e kaluar

Leonorë Bunjaku- në faqen 19 është përsëritur një gabim, sepse në vend se të thuhet mësimdhënësit thuhet nxënësit.

Aprovohet procesverbali me këtë vërejtje, me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit.

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa

2.1 Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Gjilanit 2016-2018

Zijadin Maliqi- në bazë të analizave që unë i kam bërë mund të them se kjo është një kornizë e punuar mirë dhe i posedon të gjitha elementet e nevojshme për një kornizë të tillë. Ne kryesisht duhet të bazohemi në pjesën e parë kryesisht në buxhetin për vitin 2016, pastaj janë edhe dy vite të tjera të cilat janë si orientim, por të cilat në të ardhmen mund të ndryshojnë. Kjo kornizë është hapi i parë i cili duhet të kalojë për të ardhur deri te hapi i fundit e që është aprovimi i buxhetit Komunal i cili është paraparë sipas kalendarit. Kjo kornizë e cila është sot para anëtarëve të Kuvendit, është kërkesë e Komunës për buxhet për vitin 2016 e që është jashtë kufijve buxhetor. Kjo kornizë do të thotë është kërkesë për plotësimin e nevojave të Komunës së Gjilanit e të cilat nevoja janë shumë më të mëdha, por këto janë kërkesa modeste. Shihet se me këtë kornizë kemi një rritje të buxhetit diku për mbi 6 milion 400 mijë €. Kjo rritje e përgjithshme reflekton në rritje të pagave dhe atë në atë 0.5% për përvojën e punës, por edhe për sigurimin shëndetësor i cili planifikohet që të zbatohet nga viti 2016.

Te kjo kategori kemi një rritje për 10% në krahasim me vitin 2015, kurse te mallrat dhe shërbimet kemi një rritje prej 18% e që do të ndikojë te arsimi, sepse me rritjen e numrit të objekteve, rriten edhe nevojat për mirëmbajtjen e këtyre objekteve e të cilat kërkojnë mjete financiare. Një rritje e dukshme është paraparë te subvencionet e sidomos në bujqësi, shëndetësi, rini dhe sport, por edhe në kategori të tjera. Mirëpo rritje më e madhe është tek investimet kapitale e që është diku për 88% më tepër se viti 2015. tek të hyrat vetanake kemi një rritje të lehtë e që është një shumë afër 4 milion € për vitin 2016. Ky është një propozim buxhet, kurse MEF do ta bëjë kornizën, por është vështirë që të thyhen kufijtë buxhetor, sepse ekziston një formulë për ndarjen e grandeve, por mendoj se është shumë mirë që kemi propozuar këtë propozim buxhet dhe kërkoj që ta aprovoni unanimisht.

Riad Rashiti- unë me pak fjalë po e them se kjo kornizë absolutisht nuk ka të bëjë me realitetin dhe mundësitë e Komunës për zhvillimin e saj gjatë vitit 2016-2018. Ka shumë arsyeje dhe faktorë pse po e them këtë të cilët ndikojnë negativisht dhe pamundësojnë realizmin e kësaj kornize buxhetore.

Së pari nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka qenë desh të bëhet një prezantim më i qartë dhe t' i arsyetojë parashikimet dhe parametrat e paraqitura në këtë kornizë.

Së pari nuk është serioze kur në sektorin e shëndetësisë planifikohen projekte kapitale për rini, sepse në këtë mënyrë janë ngatërruar shumë të dhëna dhe shifra. Janë fut shifra paushalle të shifrave, sepse jeni munduar që Komuna ta paraqitni që Komuna për vitin ardhshëm do të ketë zhvillim. Ne dëshirojmë të jetë dhe të ndodh kjo, or nuk është mirë të filloni me fontanë dëshirash çka duhet të punohet në Gjilan, por duhet të paraqiten gjërat reale të cilat duhet të investohen.

Ju keni theksuar se burimet kryesore të të hyrave janë nga grandet dhe të hyrat vetanake komunale dhe thuhet se kanë pasur rritje nga viti në vit. Kjo është shumë e vërtetë, por për vitin e ardhshëm një rritje jashtëzakonisht e madhe nuk është e bazuar.

Në vijim të fjalës së tij z. Rashti i lexon nga raporti disa të dhëna të cilat fare nuk përputhen me realitetin, sepse me përshkrim është thënë diçka tjetër, kurse me shifra është thënë diçka tjetër.

Te tabela e paraqitjes te grandet, sepse për vitin 2015 grandit i përgjithshëm ka qenë mbi 6 milion 854 mijë €, kurse për vitin 2016 është 6 milion e 334 mijë € e që do të thotë 520 mijë € më pak. Kërkoj që mundësisht pse dallon ko shifër dhe pse është më pak. Vlerën më të madhe e keni paraqitur te

kontingjenti qendror, sepse këtë vit janë planifikuar 559 mijë €, kurse në vitin e ardhshëm 6 milion e 377 mijë €. Është mirë të na jepni sqarime se në çka është bazuar kjo rritje? Unë besoj se këtu është bërë një shifër vetëm sa për të thënë se Gjilani do të zhvillohet vitin e ardhshëm. Te të hyra keni parashikuar rritje jo reale e si shembull është se për leje ndërtimi këtë vitin i keni planifikuar 680 mijë €, kurse vitin e ardhshëm 850 mijë € apo 170 mijë € më shumë. Në bazë të parametrave që jeni duke inkasuar këtë vit keni rënie drastike të të hyrave nga ky burim financiar. Nga të gjitha të dhënat shihet se keni parashikuar të hyra në vitin e ardhshëm për pa u bazuar në realitet qoftë nga të hyrat vetanake qoftë nga grandet. Te investimet kapitale iu uroj që të ndodh kjo, sepse Gjilani ka nevojë për investime të tilla dhe të jetë kjo rritje. Ky planifikim është o real dhe jo profesional, sepse në këtë 6 milion 730 mijë €, vetëm për bujqësi janë planifikuar 1 milion e 681 mijë €. Është mirë të na epen të dhënat se cilat projekte Komuna i ka të planifikuara për investime kapitale? Nëse janë subvencione ka qenë desh të futen te subvencionet dhe te investimet kapitale.

Në vijim të fjalës së tij z. Rashti pati edhe disa vërejte të tilla në këtë kornizë buxhetore.

Krenare Latifi- ne si grup i LVV nuk pajtohemi me këtë ndarje apo planifikim të buxhetit për periudhën tri vjeçare, sepse përkundër një debati që është organizuar nga drejtoria përkatëse, mendoj se ka pasur nevojë të konsultohen përkatëse dhe merren për bazë përvojat dhe kërkesat e tyre.

Ne mendojmë se në këtë kornizë buxhetore më tepër iu ka dhënë prioritet mallrave dhe shpenzimeve dhe jo investimeve kapitale, por jo edhe përkrahje më të madhe sektorëve të ndryshëm siç është shëndetësia dhe arsimit. Si shembull është se edhe sot e kemi në prioritet ndarjen e bursave për Shkollën e Bujqësisë, sepse kjo shkollë rrezikohet të mbyllet, por në këtë kornizë buxhetore nuk kemi fare rritje në sektor të arsimit. Tek të hyrat vetanake dhe grandet operative sa i përket tabelës një tek indikatorët ekonomik kemi vërejtur se qeverisja e juaj nënvizon faktin se do të ketë ecuri kolektive që rritjet reale ekonomike në tri vitet e ardhshme në një normë prej 4.2%, 5.0, 5.8% të bruto produktit vendor dhe njëkohësisht rritje të inflacionit nga 1 në 2%. Po ashtu ka zotime se do të krijohen vende të reja të punës dhe zbutje të papunësisë, por do të kisha pasur dëshirë ta specifikoni më detalisht kur dhe ku dot ë hapen këto vende të punës dhe sa mendoni ta ulni papunësinë.

Edhe te tabela te planifikimi i të hyrave vetanake dhe grandeve është planifikuar rritje graduale, por te pika 1 e grandeve të përgjithshme ka ulje në vitin e dytë e më pasta rritje simbolike në vitet e ardhshme. Pika 3.2.2 te zhvillimi i politikave të reja në të gjitha nën pikat, por në nën pikën 4 thuhet (lexohet kjo nën pikë), prandaj unë bëj pyetje se si prezantohet korniza afatmesme buxhetore, kurse nuk ka informata për ndarjen e buxhetit për vitin 2016-2018.

Te pika 3.3 shpenzimet komunale sipas parashikimit për vitin 2016-2018, kjo kategori e shpenzimeve është në rritje të konsiderueshme, kurse në anë anën tjetër kur shikojmë te tabelat për të hyrat vetanake në këta sektor nuk kemi rritje të tillë. Në këtë kornizë buxhetore ka tendencë të rritjes së shpenzimit të shërbimeve dhe mallrave, kurse në anën tjetër nuk ka tendencë të rritjes të të hyrave vetanake. Gjithashtu edhe te tabela për projektet kapitale për vitin 2016-2018, këto projekte nga viti në vit të jenë të njëjta dhe me kosto të njëjtë pa asnjë ndryshim!

Mevlyde Zejnullahu – ne si grup e kemi anlizuar këtë kornizë buxhetore dhe kemi konstatuar se korniza është punuar mirë në çdo segment të buxhetit. Mirëpo korniza buxhetore parasheh planifikimin buxhetor për vitin 2016-2018 e sidomos planifikimin buxhetor për vitin 2016.

Hartimi buxhetor i kësaj kornize përcakton kufijtë buxhetor të Komunës nga MEF për vitin 2016.

Në kornizë është bërë një detajim i mirë e sidomos te ndarje prioritete për realizmin e objektivave të Komunës. Planifikimi i rritjes së grandeve qeveritare prej 26.98 në 27.38% për vitin 2016 dhe rritja e të hyrave vetanake nga 3.83 deri në 8.31% për tri vitet në vijim dot ë thotë se është një planifikim i hartuar mirë dhe jep shpresa për një zhvillim më të mirë të Komunës. Sipas kësaj kornize, prioritet i epet investimeve kapitale dhe vitin 2016 na ep shpresa për një rritje ekonomike të Komunës dhe ne si grup i AAK-së e përkrahim këtë kornizë afat mesme.

Nevzad Isufi- në radhë të parë propozoj që ta bëni një ndryshim në titull të këtij materiali dhe fjala kornizë të hiqet tërësisht, sepse është përdorur pa vend dhe pa nevojë, sepse nuk gjendet askund në fjalorin e gjuhës shqipe (ekonomik financiar).

Sa i përket këtij buxheti në atë që hartuesi e ka quajtur vizion të Komunës për të vitet e ardhme e të cilat janë shënuar me shkronja të veçanta dhe me nënvizim. Në radhë të parë thuhet një zhvillimi qëndrueshëm ekonomik dhe është thënë : “Gjilani si qendër me urbanizëm modern”. Mirëpo shikuar në praktikën e deri tashme sidomos në periudhën e qeverisjes së tashme komunale duke sikur ironi, sepse nuk kemi një urbanizëm modernë dhe nuk respektohet asnjë plan dhe ndërtimi është në kaos.

Pajtohem me atë që ju i keni dhënë përparësi ose prioritet, por arsytimit e këtyre prioriteteve janë të zbehta dhe kjo zbehje përputhet me shifra financiare të planifikimit. Nuk ka ndonjë shpjegim të shkurtës se si do të bëhet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik të cilin fakt e dëshirojmë të gjithë.

Po t’ i shikojmë shifrat për vitin 2016 ku parashihet një buxhet më i mirë, por nuk është sqaruar prej nga vjen ky buxhet dukshëm më i mirë nga vitet paraprake. Sa i përket përparësisë së rritjes komunale të cilin arsyetim z. Isufi e citon nga kjo kornizë. Unë mendoj se subvencionet dhe mbështetja e bujqësisë duhet të jetë si pikë e parë. Askund nuk përmenden ato 3 mijë biznese që veprojnë në Komunën tonë. Nuk përmendet asnjë arsyetim ose stimulim i ndonjë prodhuesi vendor, sepse vetëm kështu gjenerohen të ardhurat dhe vendet e reja të punës dhe bëhet një rritje ekonomike.

Vetëm në këtë mënyrë do të kishim rritje të standardit në arsim, infrastrukturë etj.

Thuhet se është paraparë një përmirësim kryesisht nga rritja e grandeve qeveritare e që për mua nuk janë inkurajuese, krahasuar me vitet e fundit, mirëpo kur përmenden politikat e reja më shumë lidhet me një skepticizëm të dyshimtë se sa këto parashikimet e tashme. Përmendet zvogëlimi i grandeve të komunave në 10%, ndryshimi i formulës shtetërore për ndarje të buxhetit për arsim dhe ndryshimi se çështjet sociale do të kalojnë në kompetenca të komunës etj. Kur bëhet fjalë për subvencionet ato edhe më tutje mbeten simbolike sipas mendimit tim e sidomos në arsim, sepse ato mbesin lineare për tri vitet e ardhshme. Vazhdimisht thuhet se arsimi do të ketë përparësi, por në fakt në buxhet nuk është ashtu! Mirëpo të njëjtat vlejnë edhe për shëndetësinë, kulturën etj. Po ashtu te investimet kapitale për tri vitet e ardhshme nuk përmendet asnjë plan konkret. Këto ishin ato sugjerimet dhe vërejtjet e mia e të cilat kërkoj që t’ i keni në konsideratë.

Fehmi Sylejmani- unë e kam vetëm një pyetje konkrete e cila ka të bëjë me arsimin. Nëse shkojmë me 50 mijë € subvencione për arsimin me siguri nuk do të ketë bursa për vitin e ardhshëm. Të gjithë ne duhet ta dimë se me këto subvencione nuk do të ketë bursa për studentë, nëse ndajmë bursa për Shkollën e Agro-Biznesit. Për këtë arsyeje unë kërkoj nga drejtori i financave që këtë shifër ta rrit në 100 mijë €, sepse në vitin e ardhshëm nuk do të ketë mjete për bursa.

E dyta kërkoj që në shpenzimet kapitale në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik të rregullohen salla sportive për shkollat e Gjilanit. Gjithashtu drejtori për ekonomi dhe Financa në arsim të shikojë që të rregullojë terrene sportive të hapura dhe kabinete.

Në Drejtori të Arsimit dihet se ndarja e mjeteve bëhet me parametra 21.3% për kokë të nxënësit. Kjo ekonomikisht është kështu, por logjikisht nuk qëndron, sepse nuk ka nxënës gjysmë, prandaj kjo duhet të rumbullakohet.

Ilmi Limani- së pari është mirë që tabelat t’ i lexoni mirë dhe mos të thuhet ato që nuk qëndrojnë. Projekte të shëndetësisë të cilat janë përfshirë në kulturë nuk ka. Sa i përket buxhetit, ndryshe është pjesëmarrja e buxhetit të Komunës dhe ndryshe është ajo që e ndan qeveria. Është e vërtetë se grandit i përgjithshëm në nivel të Qeverisë ka rënë në nivel të Kosovës, por shifrat janë të sakta prej Qarkores buxhetore të cilën e ka dërguar MEF-i me përjashtim të kontingjenteve nga buxheti qendror. Pse këtë 6 milion e kemi kërkuar do ta shpjegojmë kur të vijmë te problemi i arsimit, sepse e kam edhe atë analizë. Sa i përket dhuruesve të jashtëm këtu janë vetëm dhuruesit e jashtëm që kanë mbledh mjete në buxhet të Komunës në kodin 651, por jo edhe dhuruesit që kanë financuar drejtpërsëdrejti.

Sa i përket rrugës me katër korsi që u përmend, për këtë projekt janë zotuar mjetet nga Ministria e Infrastrukturës, të cilin zotim e kemi në Departamentin e Prokurimit. Janë përmend të hyrat nga urbanizmi, por këto janë kërkesa të drejtorive, kurse Drejtoria për Buxhet dhe Financa vetëm i ka përpunuar. Në vazhdim të fjalës së tij drejtori i Financave dhe sqarime të tjera përkitazi me financimin arsimit dhe funksionimin normal të kësaj lëmie me rëndësi. Te bujqësia subvencion janë mbi 681 mijë €, kurse investime kapitale janë vetëm 165 mijë €. Sa i përket projektit të Lumit Mirusha është e ditur se participon edhe Qeveria, por edhe Komuna.

Riad Rashiti- ne e kemi lexuar bukur mirë këtë kornizë, por unë e thash në fillim se tjetër diçka keni shkruar dhe tjera shifra keni paraqitur në tabela. Se a keni paraqitur projekte kapitale te Shëndetësia duhet ta lexosh faqen 4, të cilin pasues z. Rashiti e lexon. Unë bëra pyetje pse projektet i Rinisë janë planifikuar nga burimi financiar i shëndetësisë, unë këtë e lexova dhe nuk e kam shkruar.

Në këtë kornizë planifikimi i buxhetit të Komunës është jo real dhe nuk arsyetohet me atë se nuk e ma bërë unë, por ai tjetri. Problemi i arsimit ka qenë edhe në qeverisjen tonë, por ju tash duhet ta zgjidhni këtë problem.

Te investime kapitale 6 milion e 731 mijë €, janë nga të hyrat kontingjente nga buxheti dhe këto janë të planifikuara paushallë.

Fehmi Sylejmani – është mirë që kur të bëhet debati publik të bëhet në mënyrë parciale, të thirren një ditë ekonomistët, një ditë tjetër punëtorët e arsimit, të shëndetësisë në mënyrë që me të vërtetë të jepen vërejtje dhe sugjerime shumë profesionale.

E dyta është se drejtori e shpjegoj formulën se si ndahen mjetet për mësimdhënësit, por kërkoj që a ka mundësi që sipas formulës që keni vepruar ju të ndërrohet dhe të bëhet financimi sipas normës. Këto parametra që janë aktual duhet të bëhet presion dhe duhet të ndryshohet.

Në komunën e Gjilanit janë 4 shkolla që punojnë me pilot-projekt dhe është e nevojshme që të rriten mjetet për mallra dhe shërbime pikërisht për shkak të zbatimit të korrikulës së re.

Ilmi Limani- në faqen 4 që u përmend, mua më duket se nëse bëhet një sallë e edukatës me siguri ajo ndikon në shëndetin e nxënësve. Faqe 4 nuk ka lidhje me buxhet, sepse çdo drejtori ka detyrim ndaj drejtorisë tjetër.

Sa i përket formulës këtë nuk e ka bërë Komuna e Gjilanit, formula është e tillë dhe ne nuk mund ta ndryshojmë.

Zijadin Maliqi- unë e thash në fillim se ky është një propozim buxhet për vitin 2016 dhe për dy vitet e ardhshme, por kryesisht ne duhet të bazohemi për vitin 2016. Ky është hapi i parë i Komunës që ka punuar në këtë drejtim, sikurse që është edhe hapi i parë i nxjerrjes së qarkores buxhetore në nivel të ministrisë. Ne sikur të kishim shkuar me atë qarkoren e parë të ministrisë nuk do kishim fare këtë gjendje, sepse do ta kishim një buxhet edhe më të keq se në vitin 2015. Ky është një propozim, por ne duhet të kërkojmë më shumë, por sa do ta realizojmë do ta shohim më vonë. Është mirë që këtë ta aprovojmë ta dërgojmë si kërkesë me mbi 6 milion, kurse më vonë ministria ta merr hapin tjetër. Për mua ky është një propozim shumë i mirë dhe nëse realizohet kjo, mendoj se do t' i kemi punët bukur mirë.

Nuk pati debatues të tjerë përkitazi me këtë pikë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovet pika 2.1 e rendit të punës?

Aprovet pika 2.1 e rendit të punës: Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Gjilanit 2016-2018, me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.